



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.14/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat, si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P. nr. 664/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Burbuqe Spahiu-Kërveshi, pala ankuese , nga fshati Bresalc Komuna e Gjilanit, dhe Përmbaruesi Privat, me datën 22.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-14/2022 i datës 11.05.2022, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese, , nga fshati , komuna e , e datës 05.05.2022, **si të pa bazuara.**

II. Përmbaruesi Privat , si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbarimore P. nr. 664/2021.

A r s y e t i m

Me datën 05.05.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbaruesit Private, me të cilën pretendon se përmbaruesi privat, ka vepruar në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, duke mos vepruar konform nenit 21 dhe 29 të LPP-së, si shkak se fatura mbi të cilën është lejuar përmbarimi nuk është nënshkruar e as pranuar nga pala ankuese. I ka propozuar për komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbaruesi privat.

Me datën 11.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komisionin Raportin Përfundimtar ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbareuesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se ankesa për fillimin e procedurës dicitpline e është parashtruar jasht afateve ligjore të përcaktuara sipas nenit 375 të LPP-së, duke i propozuar komisionit që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbareimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbareuesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbareuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, pasi vlerësoi pretendimin e palës ankuese gjeti se ankesa e parashtruar nga pala ankuese është iniciuar si procedurë pas afatit të përcaktuar ligjor me nenin 375 të LPP-së, ngase pala ankuese ka rënë në dijeni për veprimet e përmbareuesit privat me datë 22.06.2022, siç e deklaroi edhe vet pala ankuese në seancë dëgjimore, ndërsa ankesën e ka paraqitur me datë 05.05.2022. Nga kjo rezulton të jetë se ankesa është paraqitur për më tepër se një vit nga dita kur ka rënë në dijeni pala ankuese për veprimet përmbareimore, pasi që afati për iniciimin e kësaj procedure sipas dispozitës së lartcekur është 6 muaj por jo më vonë se 1 vit nga dita e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye komisioni nuk u lëshua më tej në vlerësimin se përmbareuesi privat ka bërë apo nuk ka bërë veprime përmbareimore për të cilat pretendon pala ankuese, të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 14/2022 datë 22.06.2022

Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.